



VERTALING KOSOVAARS

“Centrum voor Leerlingenbegeleiding” (CLB) – Qendra për Udhëzimin e Nxënësve - në 7 pyetje

1 Çfarë është një CLB? CLB-ja është Qendër për Udhëzimin e Nxënësve. Çdo shkollë në Flanders punon me një qendër të tillë. Një ekip doktorësh, infermieresh, punonjësish socialë, psikologësh dhe pedagogësh punojnë në çdonjërin CLB. Së bashku me shkollën, ekipi siguron që fëmija juaj të mund të zhvillojë njohuritë, talentet dhe kompetencat e tij/të saj sa më shumë që të jetë e mundur.

2 A jam edhe unë e/ mirëpritur në CLB? Padyshim që jeni. Prindërit dhe mësuesit, si dhe fëmijët ose vetë adoleshentët, mund të shkojnë direkt aty për informacion, ndihmë dhe udhëzime. Disa CLB punojnë me një punonjës ndërkulturor, i cili e lehtëson udhën e njerëzve nga kultura të tjera.

3 Për çfarë lloj problemesh mund të shkoj në CLB?

- Nëse fëmija juaj ka vështirësi me leximin, shkrimin, mësimin ose studimin;
- Nëse keni pyetje rreth zgjedhjes së kurseve, opsioneve të studimit, certifikatave dhe diplomave;
- Nëse fëmija juaj nuk ndihet i qetë në shkollë: stresi, frika se do të dështojë, ngacmimet, sjellja e dhunshme, mungesat në shkollë;
- Nëse fëmija juaj mund të ketë probleme shëndetësore: vaksinimet, probleme me rritjen, përdorimi i drogës, obeziteti, etj

4 Si funksionon CLB-ja? Nëse keni pyetje ose probleme, është më mirë të flisni rreth tyre më parë me shkollën. Në shumicën e rasteve, mësuesja, (*zorgleraar*) (mësuesja që zgjidh problemet) ose drejtoresha / drejtori mund t'ju ndihmojnë. Por në disa raste një vizitë në CLB është e nevojshme. Këshilltari/ja e CLB-së shqyrton pyetjen tuaj dhe kërkon një zgjidhje së bashku me ju. Në disa raste, CLB-ja do t'i kërkojë fëmijës t'i nënshtrohet testeve shtesë. Ose mund të ndodhë që problemet janë kaq të mëdha sa duhet ndihmë më e specializuar. Për këtë arsye, CLB-ja funksionon në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha llojet e shërbimeve dhe ekspertëve: qendra për trajtimin e problemeve të mësimin, shërbimet e shëndetit mendor, qendrat e rehabilitimit, etj.

5 A duhet fëmija im të shkojë në një ekzaminim mjekësor të CLB-së? Po, çdo fëmijë në Flanders duhet të shkojë në CLB për një ekzaminim mjekësor në vitin e dytë në kopsht, në vitin e pestë të shkollës të nivelit primar dhe në vitin e tretë të shkollës në nivelin sekondar. Kjo është e detyrueshme.

Doktori i CLB-së teston sytë dhe veshët, mat dhe peshon fëmijën tuaj. Ai/ajo gjithashtu shikon dhëmbët e fëmijës dhe pozicionin e trupit, e përcakton nëse ai/ajo po zhvillohen normalisht. Në këtë mënyrë, doktori mund t'i dallojë shpejt sëmundje në stadet e hershme dhe t'i parandalojë që të përkeqësohen. Nëse doktori i shkollës shikon ose dyshon për një të tillë, këshilloheni, për shembull, të bëni një ekzaminim më të specializuar tek specialisti. Doktori po ashtu monitoron vaksinimet e fëmijës tuaj.

Nëse nuk doni që doktori i CLB-së të kontrollojë fëmijën tuaj, kontrolli mund të bëhet edhe nga një doktor i përgjithshëm. Ai/ajo do të bëjnë të njëjtat analiza e do t'i dërgojë rezultatet tek doktori i CLB.

6 A më duhet të paguaj për shërbimet e CLB-së? Jo, ndihma dhe udhëzimi për fëmijën tuaj nga CLB-ja janë falas.

7 Ku gjendet një CLB?

- Të dhënat e kontaktit të këshilltarit të CLB-së do të gjenden patjetër në broshurën e shkollës.
- Punonjësi e CLB-së shpesh punojnë disa orë pranë shkollave.
- Shkoni në qendrën tuaj të CLB-së. Ajo është e hapur çdo ditë të shkollës. Punonjësit e CLB-së po ashtu janë në dispozicion në disa ditë të caktuara gjatë pushimeve shkollore.

Ky tekst është një përmbledhje e shkurtër e broshurës “Het CLB in 15 vragen” (“CLB-ja në 15 pyetje”). Broshura është shkruar në holandisht të thjeshtë. Mund të përpiqeni ta lexoni tekstin në holandisht me ndihmën e këtij përkthimi të shkurtër. Rritja dhe edukimi nuk bëhen vetëm në shkollë. A doni të mësoni holandisht? Gjeneroni një vend për ta mësuar afër jush në www.huizenvanhetnederlands.be ose pyesni në shkollën e fëmijës tuaj.